

GJAKMARRJA - NGA PLAGËT E SHOQËRISË SONË

Droga, alkooli, prostitucioni, gjakmarrja janë fenomenet që ndeshen më shumë në shoqërinë moderne, të cilat janë sëmundje të lidhura me natyrën e njeriut si individ. Njeriu është një qenie biosociale e komplikuar. Tek ai shfaqen ndjenja të shumta: të dashurisë, humanizmit, të së bukurës, por herë-herë shfaqet edhe ndonjë ndjenjë e egër, që mund të sjellë një sërë rrjedhojash negative: urrejtje, zemërim, hakmarrje.

Në periudhën e tranzicionit, mes të tjerash, u rishfaq dukshëm në përmasa tepër shqetësuese një ndjenjë e egër primitive, e cila në mjaft raste nuk përfill as të drejtën zakonore, ku është sanksionuar. Është fjala për hakmarrjen dhe zhvillimin më të lartë të saj: gjakmarrjen.

Vizioni i hakmarrjes është i gjerë, duke përfshirë sfera të dukshme e të padukshme. Hakmarrja përfshin jo vetëm fushën sociale, por edhe atë politike, ekonomike, madje duke u futur në të gjitha shtresat e shoqërisë. Aspekti në të cilin jam ndalur në trajtimin e kësaj plage të shoqërisë sonë, është ai social.

Ndryshimet ekonomike e sociale që ndodhën në vendin tonë pas vitit 1990 patën ndikime pozitive, por u shoqëruan edhe me dukuri negative në jetën e shoqërisë dhe, në veçanti, në atë të rinisë. Një ndër ato, është droga, e cila ka filluar të përhapë metastazat edhe në Shqipëri.

Miliona të rinj sot veprojnë duke injektuar, gëlltitur, thithur me hundë dhe duke tymosur, që nga kokaina, deri tek marijuana. Grupi moshor më i ekspozuar ndaj këtij rreziku janë të rinjtë e moshës 15-25 vjeç.

Tregu i shpërndarjes së drogës është tregu me fitimet më të larta. Këto substanca, që vite më parë janë përdorur në mjekësi dhe për qëllime mjekësore, tani gjenden kudo si substanca që qarkullojnë në përdorim të fshehtë publik.

Gjakmarrja, efektet e saj në shoqëri dhe situata konfliktuale

Gjakmarrja, si një institucion tradicional i jetës së shqiptarëve, nuk është më një relikte ose institucion i së kaluarës. Disa rrethana të zhvillimit ekonomik, shoqëror, kulturor dhe politik të vendit gjatë dekadës së fundit e kanë vendosur gjakmarrjen në një kontekst të ri social.

Gjendja gjatë dhjetë vjetëve të fundit ka arritur në një pikë të tillë, sa që vdekja po ulëret me breshëri të të gjitha armëve, gati çdo ditë, duke mbushur pafundësisht kronikën e zezë të shtypit. Kjo bëhet më cinike kur rreth tetë vjet më parë Gjykata Kushtetuese mori vendimin historik që e shpalli dënimin me vdekje si të papajtueshëm me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se ka pasur periudha kohe gjatë dhjetë vjetëve të fundit, që shteti është shembur apo ka qenë formal, duke mundësuar kalimin e armëve pa asnjë kontroll, në duart e individëve, të cilët për motive nga më banolet, nga vetëgjyqësia, për fitim pronash, trafik femrash dhe të drogës, kaluan në hakmarrje dhe gjakmarrje.

Vrasjet janë krime të rënda, që prekin të drejtën për të jetuar, si e drejta më themelore e njeriut, e mbrojtur në Deklaratën Universale të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1948), në Konventën Evropiane (1950), dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 21).

Pikërisht se vrasjet janë plagë e rëndë shoqërore që nga lashtësia, kanë tërhequr vëmendjen e filozofëve, shkrimtarëve, sociologëve, juristëve dhe mendimtarëve të tjerë. Për gjakmarrjen në Shqipëri, e cila ka shuar familje të tëra, kanë shkruar shumë autorë të huaj e, sidomos albanologët e njohur: J. G. Hahni, F. B. Nopça, E. Durhani, S. Villari, G. Kasteletti etj. Me këtë problem të rëndësishëm janë marrë edhe rilindësit tanë të mëdhenj, si: S. Frashëri, P. Vasa, Z. Jubani, J. Vreto, A. Drenova e deri në ditët tona shkrimtari i njohur I. Kadare, si dhe mjaft njerëz të punës në Shqipëri e Kosovë.

Studiuesit shqiptarë në Shqipëri e Kosovë nisen nga teza

themelore se vrasjet për gjakmarrje janë fenomene patriarkale historiko-shoqërore. Në kohët e lashta, në formacionet parashtetërore, gjakmarrja ishte mjet i vetëmbrojtjes. Në rendin patriarkal fisnor mori përhapje të gjerë, ndërsa në mesjetë filloi të kufizohej sipas parimit «sy për sy», «dhëmb për dhëmb». Ky proces vazhdoi në shekujt e mëvonshëm deri në zhdukjen e plotë të saj. Vrasjet për gjakmarrje nuk kanë qenë vetëm fenomen shqiptar, por kanë pasur karakter ndërkombëtar. Ato kanë ekzistuar në kohë të ndryshme, në vende të tjera të botës, si: në Greqinë e vjetër, Romën e vjetër, Azi, Arabi, te hebrenjtë, te gjermanët, sllavët, në Kaukaz, Korsikë e gjetkë. Diku ato janë zhdukur më herët e diku më vonë.

Veçoria e Shqipërisë qëndron në faktin se vrasjet për gjakmarrje vazhduan e vazhdojnë në disa zona më gjatë, për shkaqe të brendshme e të jashtme, objektive e subjektive.

Ndër këto, më kryesoret janë: ekzistenca për shumë shekuj e marrëdhënieve patriarkalo-fisnore, organizimi vetëqeverisës, krijimi me shumë vonesë i shtetit të pavarur shqiptar (28 nëntor 1912), prapambetja e përgjithshme social ekonomike, arsimore e kulturore, forca e madhe e mendësive të së kaluarës, si dhe pushtimet e gjata të huaja.

Mendimtarët shqiptarë, mbështetur në përvojën shekullore të popullit shqiptar, kundërshtojnë me të drejtë si të pabazuar pikëpamjen e atyre autorëve të huaj të cilët shprehen se gjakmarrja, gjoja është veçori biologjike, racore e shqiptarëve.¹

Gjakmarrja është dukuri sociale që ka një fillim e një mbarim dhe nuk është fatalisht e pashmangshme. Kufizimi i gjakmarrjes shihet qartë në të drejtën zakonore penale të shqiptarëve, në kanunet mesjetare. Kështu p.sh., në Kanunin e Lekë Dukagjinit parashikohet rregulli se vetëm dorasi binte në gjak (paragrafi 898) «gjak për gjak», «gjaku shkon për gisht». Ky rregull është shprehur edhe në Kanunin e Skënderbeut, në Kanunin e Labërisë dhe në Kanunet vendore. Gjithashtu, në kanune parashikohej në vend të vrasjes për gjakmarrje, shpërblimi i gjakut.

Në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit, At Gjergj Fishta thoshte se «vrasja, sipas kanunit, dënohej, por, duke mos pasur shtet e gjyqe, i lihej shteg vetëgjyqësisë, gjakmarrjes

individuale, si mjet i vetëmbrojtjes». Që këtej, Fishta nxjerr konkluzionin se «asht gabim të thuhet që të marrunit e gjakut shënon barbarinë e kombit shqiptar, por buron nga do ndorje që nuk varen prej shpirtit të këtij kombi, por prej organizimit shoqëror të tij». Ajo që vlen për t'u theksuar është se kanuni jep mjaft raste që nxisin vetëpërmbytjen. Në nenin 208 të kanunit thuhet: "Gjaku për faj nuk jet" dhe shpjegon "Çdo faj që t'ia baj shqiptari shqiptarit, tager ka me mundue me pleq e me ... , porse nuk mund ta vrasë se "Gjaku për faj nuk jet".²

Rol të madh në mbrojtjen e jetës së njeriut dhe në kufizimin e gjakmarrjes në të kaluarën ka luajtur instituti i besës dhe i ndorjes, si bazë e ndërmjetësimit të pajtimit, të besëlidhjes kolektive në kuvendet tradicionale nga jugu në veri e deri në Kosovë e Mal të Zi.

Faktet historike tregojnë se gjakmarrja në Shqipëri në kushtet e ekzistencës së shtetit të së drejtës pozitive, ka shkuar vazhdimisht drejt kufizimit dhe zhdukjes në pjesën më të madhe të vendit.

Me kalimin nga shteti totalitar në demokracinë pluraliste, në vitet "90", u rishfaqën vrasjet për gjakmarrje në disa zona të Shqipërisë veriore e verilindore.

Në vitet 1991-1995, sipas të dhënave që janë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (mars 1996) ishin kryer gjithsej 953 vrasje, nga këto - 91 ose 9.5 % ishin për motive gjakmarrjeje.

Në Shqipëri ndodhi, ashtu siç ka thënë kriminologu i njohur amerikan Edvin Sutherland, që «çorganizimi shoqëror» shpuri në «çorganizim individual», demokracia u keqkuptua si anarki, si vetëgjyqësi dhe u tronditën vlerat pozitive të popullit shqiptar.

Në këto vite u shfaq një dukuri e re sociale, sepse vrasje për gjakmarrje u kryen jo vetëm në Shqipërinë veriore e verilindore, por edhe në Fier, Berat, Vlorë etj., ku ato ishin zhdukur para disa dekadash. Ngjarjet e vitit 1997 i thelluan më tej shkaqet e vrasjeve për gjakmarrje, si rrjedhojë e mosfunksionimit të aparatit shtetëror (të policisë, prokurorisë, gjykatave e ushtrisë). Kusht tjetër favorizues ishte moszbulimi e moskapja në kohë e të gjithë fajtorëve nga policia, hetimi i mangët dhe joobjektiv i çështjeve nga prokuroria, dhënia e

dënimeve të buta ose e pafajësisë, si dhe lirimi para kohe, me kusht, jashtë kriterëve ligjore nga gjykata. Aty ku nuk funksionon mirë shteti e ligji, vepron vetëgjyqësia e kanuni.

Nuk duhet nënvlerësuar edhe aspekti psikologjik, veprimi i emocioneve, inatit, i sedrës së sëmurë, fyerjes etj. Shqiptarin e karakterizon ndershmëria, ai nuk e duron dot fjalën e vrazhdë e të rëndë. Këto ofendime përcillen nga njerëz të ndryshëm në mënyra të ndryshme: disa i përgjigjen me të butë e njerëzisht, sikur nuk ka ndodhur asgjë; tek disa të tjerë përgjigja është e hidhur, deri në ekstrem. Madje, disa janë detyruar të marrin edhe udhët e kurbetit për t'i shpëtuar plumbit të gjakmarrësit. Prandaj është shumë e rëndësishme njohja e etnopsikikës së njerëzve.

Kanuni ndërmjet traditës dhe modernitetit

Sipas grupmohave, rezulton se moshë mesatare e autorëve të vrasjeve për gjakmarrje është 26-40 vjeç, pa përjashtuar ndonjë rast si ai i një minoreneje 13 vjeçare nga Laçi, që vrau gjaksin e babës. Pikërisht se shumica e autorëve të vrasjeve janë të moshave të reja, nuk i njohin dhe nuk i kryejnë vrasjet nën ndikimin e kanunit, por nxiten nga të tjerët, se jo rrallë opinioni i referohet kanunit.³ Në praktikë vërehen shmangie të mëdha nga kanuni, se vriten të mitur, vriten pleq ose krejt familja. Shmangie të mëdha të kanunit ka sidomos në ngujim, ka që detyrohen që detyrohen të braktisin shkollën. Dihet se në fushën e gjakmarrjes vlente parimi i njohur e i patundur «nji për nji», pra, më ke vrrarë një mashkull, kam të drejtë të vras një mashkull. Në ditët tona ndodh rëndom që për një të vriten dy, tre e më tepër, meshkuj, femra, të mitur e të rritur. Sipas kanunit, mjet i ligjshëm i gjakmarrjes ishte arma e zjarrit, zakonisht pushka e shkurtër ose e gjatë. Në ditët tona nuk ka ndonjë kufizim: mund të përdoret arma e zjarrit, thika e shpesh edhe eksplozivi.

Rastet e ngujimit të fëmijëve, ndonjëherë edhe të grave janë një provë tjetër e denatyrimit të kanunit.

Njerëzit e përfshirë në gjakmarrje, jo vetëm që humbin babanë, burrin, djalin apo vëllanë e tyre, por si në një rreth

vicioz, me dhjetëra individë, të afërm të tyre, nën frikën e pasigurisë për jetën, humbasin lirinë e lëvizjes, të drejtën për të punuar, për të ushqyer familjet e tyre, të drejtat elektorale, si dhe fëmijët që humbasin të drejtën për t'u arsimuar.

Gjakmarrja, evidentimi i rasteve

Para disa kohësh, bëra një udhëtim në disa zona të veriut të vendit, ku më ra rasti të njihesha nga afër me disa familje, viktima të këtij fenomeni.

Familja Muja nga Shkodra, është një familje intelektualësh: nëna ka qenë inxhinierë, babai ekonomist (aktualisht janë në pension). Janë 12 meshkuj të ngjuar nga 18-65 vjeç. Fëmijët e tyre nuk shkojnë në shkollë. Një ndër ta është dhe Ardiani, 21 vjeç, student (me korespondencë). Vendi i tij në fakultet nuk është zëvendësuar, leksionet ia sjellin shokët. Ai nuk ka mundësi të shkojë në universitet, po ashtu edhe vëllai i tij. Thirrja që ai bën, është që të ndalohet ky fenomen, se të ardhmes së këtij vendi nuk po i jepet e drejta për t'u arsimuar. Gjithë kjo histori zhvillohet në kryeqendrën e veriut, në Shkodër.

Një histori tjetër është, akoma edhe më tragjike. Është fjala për Kadri Culaj, mjek pediatër, i cili ka gjashtë vjet që është paralizuar, jeton në një karrocë me rrota. Gjatë bisedës që bëra me atë, ai më tregoi historinë e tij: Një natë Kadriut i sjellin në spital një paciente në gjendje shumë të rëndë, e cila nuk arrin t'u shpëtojë kthetrave të vdekjes. Të shqetësuar, njerëzit e saj bëjnë fajtor mjekun dhe e rrahin në një mënyrë barbare, sa e lënë të paralizuar. Ai nuk ka tentuar të hakmerret, se priste që shteti të vepronte, pavarësisht se vëllezërit e tij janë përpjekur disa herë. Sipas tij, kanuni sot nuk ekziston, por është një kaos i përgjithshëm, ku secili vepron si të dojë. Ai nuk e ushtron më profesionin. Dita e tij është në krevat dhe në karrocë, pasi, në të njëjtën kohë, ai ka pasur dy pasoja: është i paralizuar dhe i verbër, ndaj dhe nuk lexon dot.

Një histori tjetër është edhe ajo e Ndoc Kapcarit, i ngjuar që nga viti 1991. Ai është një Robinson Kruzo i kohëve moderne. Në vitin 1991, ndërsa ishte në radhën e bukës, grindet me një bashkëqytetarin e tij. Ndoci thotë se gjatë grindjes është goditur

me një hekur, ndërsa ai vetë e ka përplasur rivalin e tij pas shtyllës, duke e lënë të vdekur. Që nga ajo ditë, edhe pse drejtësia e nxorri të pafajshëm, ai nuk ka dalë më nga shtëpia. Kështu, ai është larguar nga qyteti dhe ka improvizuar në një fshat një shtëpi, ku jeton në mjerim të thellë. Misionarët e pajtimit të gjaqeve kanë ndërhyrë për të realizuar pajtimin, por familja e gjaksit deri tani ka refuzuar ta bëjë një gjë të tillë. I mbyllur në shtëpinë e rrethuar me blloqe betoni, një jetë plot ankth e tmerr për veten dhe fëmijët: Brenda kësaj shtëpie është një tjetër botë, sa e vështirë dhe e rëndë, aq dhe e padurueshme. I vetmi burim jetese për ta është kopshti, ku familja e Ndocit sigurojnë perimet. Vajza e tij është 20 vjeçe, ajo nuk ka shkuar në shkollë dhe nuk del nga shtëpia. Kanuni nuk e lejon ngujimin e vajzave, por Ndoci thotë se ka frikë ta nxjerrë në rrugë, se mos gjaksi ia rrëmben e ia dërgon në Itali si prostitutë. Nga koha e gjatë e qëndrimit pa lëvizur, atij i janë bllokuar kyçet dhe gjunjët. Ai ka dalë natën nga shtëpia e në mënyrë klandestine ka shkuar në spitalin ushtarak të Tiranës për t'u operuar. Ka qëndruar një natë atje dhe po përmes territ ka hyrë në shtëpinë e tij, për të mos dalë më kurrë prej saj. Këto kanë qenë të vetmet netë, kur ai e ka thyer rregullin e kobshëm të ngujimit. Gjaksi e ka sulmuar disa herë shtëpinë e tij, ndaj dhe, për t'u mbrojtur, Ndoci, gruaja dhe vajza bëjnë roje me turne çdo natë. Kështu, që prej 15 vjetësh shtyhet jeta në këtë familje. Dy fëmijët e tjerë, Ndoci i ka larguar nga shtëpia, duke i siguruar jashtë Shqipërisë. Ai thotë se po të bashkohet gruaja dhe vajza me dy fëmijët e tjerë, ai do të shkojë vetë te dera e gjaksit, që ai ta vrasë. Pesëmbëdhjetë vjet i ngujuar, i ndarë nga dy fëmijët, me frikën e vrasjes çdo ditë, jeta e tij ka humbur çdo lloj kuptimi.

Një tjetër personazh është Sherif Kurti. Djali i tij ka kryer një krim dhe, si pasojë, shumë persona të familjes janë ngujuar. Ç'faj ka Sherifi? Ç'faj kanë njerëzit e tij?

Në fakt, të gjitha këto histori ndërtohen në bazë të një ligji të vjetër, që quhet **KANUN** e që ka rreth 540 vjet që jeton.

A është kanun ky kod që po përdorim? Në bazë të kanunit po ngujohemi? Në bazë të kanunit po i vrasim njerëzit? A lejohet me kanun të ngujohen gra e fëmijë? A lejohet me kanun të qëllosh mbi gra e fëmijë? A lejohet me kanun të ngujohet i

gjithë fisi?

Nuk janë kanunore të gjitha vrasjet e ngujimet. Sipas kanunit të Lek Dukagjinit, nuk vriten e nuk ngujohen gra e fëmijë. Sipas kanunit të Lek Dukagjinit, në qoftë se një person që është i ngjuar del jashtë për të larguar mërzinë, i shoqëruar nga gruaja, atëherë ai nuk duhet prekur.

Kanuni është një kushtetutë 540-vjeçare, kur ai ka dalë, nuk ka pasur qeveri. E gjithë kjo që ndodh, nuk ndodh për faj të kanunit, por mungesa e shtetit lejon një kriminel të përdorë si mburojë kanunin. Në kodin penal ka një nen që parashikon se, në qoftë se ti e detyron tjetrin t'i heqësh lirinë me forcë, që do të thotë ngujim, personi dënohet deri në tre vjet burg. Pra, kanuni është një lloj çengeli i vjetër, ku krimi var pushkën për t'u përlijtur: E gjithë kjo është mungesë totale e shtetit për të kundërvepruar. ⁴

Kush është shteti?!

Të gjithë akuzojnë shtetin, por nga vjen ky shtet? Kush e bën shtetin?

U fol për mungesën e shtetit, por unë do të theksoj që shteti jemi ne të gjithë që mund të japim kontributin për të përmirësuar situatën, duke dhënë shpresë për mijëvjeçarin e ri. Sigurisht që përgjegjësitë e shtetit duhet të jenë të qarta, ai duhet të ndërhyjë, të spastrojë, por, kur thuhet se nuk ka shtet, gabohet, sepse Shqipëria ekziston dhe shteti jemi ne të gjithë – mbi të gjitha, kemi Kushtetutën e Shqipërisë. Duhet gjetur një strategji, një mënyrë për ta mbyllur një herë e mirë këtë plagë të vjetër.

Në një takim me intelektualë, akademiku Rexhep Qosja tha: “Në Shqipëri ... gjejmë mosdurime të ndërsjella, madje pasione hakmarrëse, që e brejnë Shqipërinë përbrenda, që dobësojnë energjinë morale të popullit. A nuk është parë çmimi i shtrenjtë që i kemi paguar hakmarrjes!? A thua nuk janë parë tragjeditë që na ka sjellë gjakmarrja!? A thua është harruar se gjakmarrja ka çelur më shumë varre në tokat shqiptare sesa në luftërat që populli shqiptar ka bërë gjatë shekujve!” ⁵

E sotmja, që kërkon integrim e zhvillim, shtron pyetjen:

A jemi kaq shumë sa meritojmë të vetëvritemi?

Të gjithë duhet të kemi një objektiv:

- Të mbrojmë e të sigurojmë të drejtën e jetës.
- Të parandalojmë sa të jetë e mundur fenomenin e gjakmarrjes, që po sjell shumë shkelje të tjera të të drejtave dhe të lirive themelore të individit.

Roli i shkollës

Shkolla është një ndër qendrat kryesore të bashkëjetesës në shoqëri. Si e tillë, në njëerën a në tjetrën formë brenda saj shfaqen të gjitha dukuritë e bashkësisë ku ndodhet, qofshin me vlerë për shoqërinë, qofshin dukuri të dëmshme. Edhe gjakmarrja, si dukuri shqetësuese e dhjetëvjeçarit të fundit, shfaqet në jetën e shkollës.

Si institucion i specializuar i mësimit dhe edukimit, shkolla nuk mund të heshtë e të mos merret me një problem kaq të mprehtë, në radhë të parë me brezat e rinj, që janë viktimë e më pas bartës të kësaj ndjenje e cila pengon emancipimin shoqëror, zhvillimin në tërësi.

Shkollat kanë një rrezatim të dukshëm në jetën sociale, në mënyrë të veçantë, shkollat e mesme si dhe shkollat e larta. Shkolla bashkon të rinjtë në shoqëri e miqësi me njëri-tjetrin

Vrasje, djegie, vënie dinamiti, presion psikologjik, strese të pafund te fëmijët, adoleshentët e të rinjtë - të gjitha janë produkt i kësaj plage. Të vjen keq që zbrazet pushka e shqiptarit nga vetë shqiptarët në trup të shqiptarëve.

Për minimizimin e këtij fenomeni, krahas masave parandaluese që duhet të marrin institucionet përkatëse, do të ishte e domosdoshme që problemi, të futet edhe në programet shkollore. Qëllimi është që fenomeni i gjakmarrjes të mos trashëgohet te brezat më të rinj, për të thyer atë mendësi, sipas së cilës gjaku mund të lahet vetëm me gjak, sepse duhet të jenë vetëm organet përkatëse, që duhet të marrin vendimin e

duhur për dënimin e fajtorit të një vepre penale.

Gjithë veprimtaria e shkollës mbështetet në edukimin e mirëkuptimit në shoqëri, të respektit për njëri-tjetrin, të miqësisë - si tipare të një shoqërie demokratike. Një vend të rëndësishëm zë puna për njohjen me konfliktet, me përmbajtjen e tyre, si dhe rrugët për zgjidhjen e tyre, duke shmangur konfliktet që shndërrohen në burim të marrëdhënieve jo të drejta, deri në qëndrimet armiqësore me moshatarët dhe me gjithë shoqërinë. Vështrimi për to bëhet në dy drejtime: **Së pari**, të nxitet veprimtaria e nxënësve për të mbajtur qëndrim parimor në shoqëri, për të qenë kërkues në jetë, për të këmbëngulur në mendimin e drejtë se çdo konflikt mund të gjejë zgjidhje nëpërmjet diskutimit e ballafaqimit të çdo dukurie që mund të lindë në jetën e përditshme. **Së dyti**, të shmangen konfliktet si burim i qëndrimeve jo të drejta në marrëdhëniet me shokun, mësuesin, prindin etj.

Ç' duhet të bëhet me fëmijët e ngujuar? A duhen lënë ata në terrin e paditurisë?

Një nga drejtuesit e shoqatës "Drejtësi dhe paqe", e njohur në Shkodër për ndihmën e dhënë në fushën e paqes e të mirëkuptimit, shprehet: "Qëllimi ynë i parë ka qenë që të pakësojmë sa më shumë që të jetë e mundur ndjenjat e hakmarrjes e gjakmarrjes tek fëmijët, t'i shmangim ata nga procesi i kriminalizimit."

"Misioni i pajtimit" në Shkodër propozon grumbullimin e këtyre fëmijëve, në bazë fshati apo lagjeje dhe bashkimit me fëmijë të tjerë që nuk kanë këto probleme, si metodë efikase për t'i çliruar nga ankthi, stresi dhe frika.

Drejtori i një shkolle 9-vjeçare, në lidhje me format e arsimimit të nxënësve që e kanë braktisur shkollën, shprehet: "Emisionet e veçanta në radio e, veçanërisht në televizion, me elemente të kombinuara mësimdhënieje dhe argëtimi - do të shërbenin shumë për edukimin dhe nxjerrjen e këtyre nxënësve nga gjendja e rëndë psikologjike. Veçse që këto emisione të kenë efektivitet, duhet të kombinohen me punën e mësuesit në shtëpitë e tyre, që jo vetëm t'i ndihmoni, por edhe t'i kontrolloni

nxënësit.”

Mendimet e drejtuesve të shkollave, mësuesve, nxënësve e prindërve theksojnë rolin e pazëvendësueshëm të punës së mësuesit, të komunikimit të drejtpërdrejtë të tij me nxënësit, me mjediset familjare në pamundësi të funksionimit të shkollës.

BIBLIOGRAFI

1. Ismet Elezi: “E drejta zakonore”.
2. Shtjefën K. Gjeçovi: “Kanuni i Lek Dukagjinit”.
3. Musa Kraja: “Pedagogjia”, Tiranë 2002.
4. Revista “Pajtimi”, nr. 2, 2001.
5. Broshura të shoqatës “Komuniteti Emanuel”.
6. Materiale nga Konferenca Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të së drejtës së jetës”, Dhjetor, 2001.

¹⁻²⁾ Ismet Elezi, Kumtesë e mbajtur te Konferenca Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës” , dhjetor 2001.

³⁾ Ismet Elezi, Kumtesë, mbajtur te Konferenca Kombëtare “Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës” , Dhjetor 2001.

⁴⁾ Musa Kraja : “Pedagogjia”, Tiranë 2002.

⁵⁾ Rexhep Qosja, Kumtesë, mbajtur në një takim me intelektualë.

⁶⁾ Burim i informacionit: OJF-të.

⁷⁾ Broshurë “Droga”, Komuniteti Emanuel në Shqipëri.

⁸⁾ Gazeta “Intervista” nr. 479.